



REPUBLIKA E SHQIPRIË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
KRYETARI

Nr.1135/10 Prot.

Tiranë, më 29/06/ 2016

V E N D I M

Nr 73, Datë 29.06.2016

PËR
EVADIMIN E PJESSHËM TË MATERIALEVE TË AUDITIMIT
TË USHTRUAR NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË SHËRBIMIT
KOMBËTAR TË PUNËSIMIT “MBI PËRPUTHSHMËRINË DHE
RREGULLSHMËRINË FINANCIARE”

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projekt Vendimin të paraqitur nga grupi i auditimit të Departamentit të Auditimit të Buxhetit Qendror, Administratës së Lartë Publike, Menaxhimit Financiar dhe Auditimit të Brendshëm, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit të dhënë nga Drejtori i Departamentit të Auditimit, si dhe mendimin mbi cilësinë e auditimit të dhënë nga Drejtori i Departamentit Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës, në mbështetje të nenit 10 dhe 15 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”,

V E N D O S A:

I. Miratimin e konkluzioneve të dhëna nga Departamenti Juridik, Kontrollit dhe Zbatimit të Standardeve dhe Etikës, në lidhje me cilësinë e dobët të këtij auditimi, sipas të cilit:

- në hartimin e programit të auditimit, grupi i auditimit nuk ka ezauruar siç duhet procedurat e njohjes paraprake të subjektit të auditimit dhe për rrjedhojë programi i auditimit nuk i përgjigjet dhe përshtatet plotësisht veprimtarisë së subjektit të auditimit;
- disa nga pikat e programit të auditimit, sidomos ajo në lidhje me auditimin e programeve të nxitjes së punsimit, nuk mund të konsiderohen si të ezauruara pasi janë audituar në mënyrë sipërfaqësore dhe jo cilësore nga grupi i auditimit dhe
- në auditimin e procedurave të prokurimit grupi i auditimit ka përdorur në disa raste akte nënligjore të shfuqizuara.

Bazuar në këto konstatime, ky auditim konsiderohet një auditim i dobët dhe që nuk i plotëson plotësisht standardet e KLSH-së në lidhje me cilësinë e auditimit.

Për rrjedhojë, në zbatim të standardeve ndërkombëtare të auditimit, ky auditim do të evadohet pjesërisht vetëm përsa i përket pikave të programit të auditimit të cilat i plotësojnë standardet në lidhje me cilësinë, dhe do të ripërsëritet brenda një afati sa më të shkurtër kohor.

II. Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Nga auditimi mbi zbatimin e dispozitave ligjore për marrëdhëniet e punës dhe pagave, u konstatua se ndonëse në Rregulloren e Brendshme përshkruhet funksionimi i strukturës për çdo drejtori mungon përcaktimi i detyrave për çdo pozicion pune si dhe përshkrimi i detajuar i punës, konform dispozitave përkatëse ligjore. Gjithashtu nuk janë përcaktuar kriteret për rekrutimin e personelit, për të përshtatur pozicionin e punës me kualifikimin arsimor, fakt që ndikon në cilësinë dhe mbarëvajtjen e punës. *(Trajtuar më hollësisht në faqe 17-19 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

Për sa më sipër rekomandoj:

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Kombëtar të Punësimit të marrë masa për plotësimin e Rregullores së Brendshme, duke përcaktuar jo vetëm funksionet por dhe përshkrimin e punës për çdo pozicion pune, për të cilët të vendosen edhe kriteret e rekrutimit të personelit konform dispozitave ligjore në fuqi.

Menjëherë

2.a Nga auditimi i zbatimit të buxhetit për vitin 2014, institucionit Shërbimi Kombëtar i Punësimit i janë akorduar fonde në shumën totale 1,746,350,000 lekë. Ky programim ka pësuar ndryshime, bazuar në shkresën nr.16183/42, datë 31.12.2014 të Ministrisë së Financave “Kthim fondesh të pa përdorura”, drejtuar MMSR dhe Aktin Normativ nr.2, datë 29.12.2014 i KM për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr.185/2013, datë 27.12.2013 “Për buxhetin e vitit 2014”, i ndryshuar. Raportet e realizimit të treguesve buxhetorë janë hartuar mbi bazë të planit të rishikuar dhe reflektojnë një nivel shpenzimi fondesh prej 47% për programin pagesë papunësi (725,901,319 lekë), 16% për programin e nxitjes së punësimit (252,855,119 lekë), 12% për programin e Formimit Profesional, 2% për investime dhe 23% për shpenzime administrative për Zyrat e Punësimit dhe Administratën Qendrore të SHKP (352,139,240 lekë).

Deklarohet se numri mesatar i të papunëve që u trajtuan me pagesë gjatë vitit 2014 ishte mesatarisht 7.703 persona me kosto mesatare 7,860 lekë personi. Për nxitjen e punësimit janë lidhur kontrata me 361 subjekte, fonde të alokuara janë në shumën prej 252,855,119 lekë që i takon trajtimit të 3.969 personave.

Investimet janë realizuar në masën 98%, ku nivelin më të lartë e kanë investimet në pajisje kabinetesh për shkollat profesionale vlerë që arrin në 19,863,927 lekë, pjesa tjetër i takon rikonstruksioneve të zyrave të punës në Laç dhe Tiranë, në shumën 4,715,653 lekë. *(Trajtuar më hollësisht në faqe 9-17 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

2.b Me Ligjin nr. 160, datë 27.11.2014 “Për buxhetin e vitit 2015” Shërbimit Kombëtar të Punësimit i janë akorduar fonde në shumën 1,973,828,000 lekë ose me një rritje me rreth 227 milionë lekë. Ky programim ka pësuar ndryshime kështu; ka patur shtesa për programin e formimit profesional në shumën 39,324,500 lekë, për përballimin e kostos së pagave të punonjësve me kontratë me kohë të pjesshme që zhvillojnë kurset e formimit profesional. Shtesa në zërin mallra e shërbime në shumën 18,370,831 lekë. Shuma prej 9,165,831 lekë është përdorur për shlyerjen e detyrimeve të mbartura bazuar në VKM nr. 50 datë 05.02.2014 “Për miratimin e Strategjisë për parandalimin e detyrimeve të mbartura dhe të planit të veprimit “, të ndryshuar, të Udhëzimit të MF nr.5, datë 27.02.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”. Janë bërë pakësime në programin e pagesës së papunësisë në shumën 200,000,000 lekë, sipas ecurisë së hyrjeve dhe daljeve nga skema të punëkërkuësve të papunë me Aktin Normative nr. 1 datë 29.07.2015 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 160/2014 datë 27.11.2014 “Për Buxhetin e vitit 2015”, si dhe në zërin investime në shumën

3,216,000 lekë me akt/ normativ të MF me nr. 17201/69 datë 27.01.2016.

Raportet e realizimit të treguesve buxhetorë janë hartuar mbi bazë të planit të rishikuar dhe reflektojnë një nivel shpenzimi fondesh prej 38% për programin pagesë papunësie (614,398,687 lekë) nga niveli 44% i programuar dhe me rreth 100 milionë lekë më pak se realizimi i vitit 2014. Konstatohet se 27% të fondeve kanë shkuar për programin e nxitjes së punësimit (424,891,823 lekë) me një rritje gati 2 herë krahasuar me vitin 2014. Për formimin profesional kanë shkuar 213,317,780 lekë ose 13% e fondeve. Fondet për investime kanë arritur në 35,985,649 lekë nga 24,932,084 lekë të viti 2014. Investimet janë realizuar në masën 99%, ku nivelin më të lartë e zënë blerjet për pajisje kabinetesh për shkollat profesionale 12,495,679 lekë dhe rikonstruksionet e zyrave të punës në Skrapar, Vlorë, Devoll, Librazhd, Krujë, në shumën 21,386,000 lekë.

Deklarohet se numri mesatar i të papunëve që u trajtuan me pagesë gjatë vitit 2015 janë rreth 6.200 përfitues me një pagë mesatare 8,300 lekë/muaj nga 7.703 persona të trajtuar në 2014 me kosto mesatare 7,860 lekë/ personi. Për nxitjen e punësimit rezulton:

- 320 projekte përfituese në zbatim të VKM nr. 48, datë 16.01.2008 “Për masën dhe kriteret e përfitimit nga programi i nxitjes së punësimit të punëkërkuessve të papunë në vështirësi”, për 320 subjekte private të cilët kanë deklaruar marrjen e 3.183 punëkërkuessve të papunë. Fondi i përdorur është 222,457,265 lekë nga 129,180,406 lekë të përdorura gjatë vitit 2014.
- 69 projekte përfituese në zbatim VKM nr. 47 datë 16.01.2008 “Për programin e nxitjes së punësimit nëpërmjet formimit në punë” për 69 subjekte private të cilët kanë deklaruar marrjen e 1.299 punëkërkuessve të papunë. Fondi i përdorur është 136,685,671 lekë nga 109,843,775 lekë të përdorura gjatë vitit 2014.

VKM	Numri i subjekteve		Numri i pjesëmarrësve		Financimi ne fakt sipas situacioneve te konfirmuara nga thesari	
	2014	2015	2014	2015	2014	2015
27	12	17	120	192	6,578,735	12,847,701
47	51	69	1071	1299	105,087,307	136,685,671
48	174	320	2316	3183	123,573,290	222,457,265
199	21	43	117	263	5,553,367	19,419,005
248	8	18	14	29	1,144,836	4,524,242
873	97	145	426	857	9,948,400	26,087,125
TOTALI	363	612	4064	5823	252,855,119	437,782,420

Ndryshimet sidomos në fund të vitit janë në nivele më të mëdha për vitin 2015 duke reflektuar pakujdesi në programim dhe nga ana tjetër nivel realizimi jo referuar programit fillestar. *(Trajtuar më hollësisht në faqe 9-17 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

Për sa më sipër rekomandoj:

Rritja e konsiderueshme e fondeve të nxitjes kërkon jo vetëm një programim të kujdesshëm por edhe sisteme kontrolli të forta, si në nivel lokal dhe atë qendror, për të cilën duhet të ketë në gjykimin tonë një rregullore financiare të detajuar për një monitorim të unifikuar lidhur me këto projekte në çdo rajon. Mënyra e përcaktimit të kostove që mbulohe nën programet e nxitjes duhet të jetë e analizuar dhe transparente, sidomos nëse i referohemi kostove të trajnimit.

Menjëherë

3. Nga auditimi mbi prokurimet me vlerë të vogël u konstatuan parregullsi si në hartimin e Urdhrave të prokurimit ku konstatohet mungesa e emrave të anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, por edhe në arsyetimin e llogaritjes së fondit limit, në kundërshtim me kriteret e përcaktuara në VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” (për

procedurat e realizuara gjatë vitit 2014), VKM nr. 914, datë 29.12.2014 (për procedurat e realizuara gjatë vitit 2015), si dhe Urdhërat e Ministrisë së Financave nr. 92, datë 29.12.2011 dhe nr. 57, datë 12.06.2014 “Gjurmet Standarde të Auditit për Prokurimin me Vlera të Vogla dhe të Lartë”. (Trajtuar më hollësisht në faqe 55-60 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

Për sa më sipër rekomandoj:

Të merren masa që urdhrat e prokurimit për “Blerjet e vogla”, të përmbajnë emrat e anëtarëve të komisionit, fondin limit sipas kriterëve të përcaktuara në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për rregullat e prokurimit publik”.

Në vijimësi

4. Nga auditimi i praktikave lidhur me administrimin dhe dokumentimin e shpenzimit të karburantit konstatoam se urdhër dorëzimi për furnizim me karburant të automjeteve nuk ka të plotësuar të dhënat e plota kështu mungon nr. dhe data e autorizimit, lëshuesi i urdhrat të shërbimit dhe lëvizja që do të kryhet nga automjeti me karburantin e furnizuar nga magazina. Fletë udhëtimet nuk përmbajnë firmat e nëpunësit udhëtues.

Konstatohet se Zv/Drejtoresha e Përgjithshme njëkohësisht Drejtore e Shërbimeve Mbështetëse është personi i cili lëshon urdhrin për furnizim me karburant të automjeteve si dhe firmos në fletë udhëtimet e plotësuara nga drejtuesit e automjeteve, procedurë që bie në kundërshtim me nenin 26, pika 5, të Ligjit nr. 10160, datë 15.10.2009 “Për rregullimin e shërbimit të transportit të funksionarëve publik dhe nëpunësit civil”, i ndryshuar.

Nga auditimi i konsumit të karburantit për dy automjetet në përdorim nga DPSHKP, konstatohet një nivel konsumi (për vitin 2014) prej **5270 litra benzinë dhe 5470 litra naftë** ose mesatarisht 25,7 litra benzinë në një ditë/pune dhe 19,9 litra naftë në një ditë/pune. Ndërsa për vitin 2015 konstatohet dalje nga magazina e **4240 litra benzinë dhe 7550 litra naftë** pra konsumi mesatar 22,4 litra benzinë në një ditë/pune dhe 24,3 litra naftë në një ditë/pune. (Trajtuar më hollësisht në faqe 53-55 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

Për sa më sipër rekomandoj:

Drejtorja e Financës të mos lejojë realizimin e shpenzimeve të cilat nuk dokumentohen në përputhje me kërkesat e një sistemi të drejtë të menaxhimit financiar në zbatim të kërkesave të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar, UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” dhe Ligjit nr. 10160, datë 15.10.2009 “Për rregullimin e shërbimit të transportit të funksionarëve publik dhe nëpunësit civil”, i ndryshuar. Për të gjitha rastet e përsëritura të mungesave në dokumentimin e udhëtimeve të realizuara (km dhe persona të autorizuar), të kërkohet nga personat përgjegjës shpërblimi i shpenzimit të ndodhur.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Në periudhën objekt auditimi konstatohet se Shërbimi Kombëtar i Punësimit ka qenë përfitues fondesh nga UNDP, në bazë të Marrëveshjes së Bashkëpunimit me nr. 844 prot. datë 02.05.2013, mbi zbatimin e projektit nr.00080624 me titull “Për sfidat e punësimit të rinjve në nivel lokal”. Një pjesë e fondeve janë alokuar për mbulimin e kostove për udhëtim e dieta të stafit të ngarkuar me ndjekjen e këtij projekti.

Nga auditimi i shpenzimeve për vitin 2014, konstatoam parregullsi në dokumentimin e shpenzimeve për fjetje në hotel, kjo në referencë të kërkesave të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” si dhe VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim brenda vendit”.

Për dietat në shumën 965,000 lekë konstatoam parregullsi lidhur me dokumentimin e fjetjes në hotel, konstatoam mospërputhje të destinacionit në urdhër-shpenzimi me destinacionin e

fjetjes, kanë përfituar koston e fjetjes për udhëtime të cilat nuk i kalojnë 100 km largësi nga qendra e punës, kishte raste kur fatura për fjetjen nuk reflekton emrat e personave që kanë fjetur në hotel etj. Theksojmë se në marrëveshje është e sanksionuar në nenin 3 “Shërbimi Kombëtar i Punësimit do të mbulojë shpenzimet ditore për transport dhe qëndrim prej 5,000 lekë/ditë dhe 8,000 nëse ka qëndrim dhe fjetje, për stafin që ndjek trajnimin, si dhe Shërbimi Kombëtar i Punësimit duhet të jetë përgjegjës i plotë për zbatimin me kujdes dhe efikasitet të gjitha aktiviteteve në përputhje me Rregulloren e tij financiare dhe rregullat e tij

E njëjta problematikë konstatohet edhe në shpenzimet për udhëtim dieta të përfituara nga marrëveshja e bashkëpunimit nr. 1245 prot. datë 21.04. 2015 me Sëisscontact, Shqipëri, mbi zbatimin e projektit “Këshillimi drejt punësimit dhe sipërmarrjes”. Vlera e shpenzimeve të pa dokumentuara sipas kërkesave të UMF nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, kap shumën 296,000 lekë.

Praktika e gabuar në dokumentimin e shpenzimeve për udhëtim e dieta brenda vendit përfituar nga fondet e buxhetit të shtetit kështu konstatuam se për vitin 2014, janë likuiduar shpenzime pa dokumente shoqërues, faturë tatimore shitje për fjetje në hotel pa emrat e personave, diferenca midis destinacionit të urdhër shërbimit dhe faturës së fjetjes në hotel, gjithashtu konstatuam pagesa hoteli për qytetin e Shkodrës, i cili është nën 100 km dhe nuk përfshihet në dieta me akomodim, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim brenda vendit” në 133 raste në shumën 1,288,000 lekë. Për vitin 2015, nga auditimi u konstatuan 69 raste problematike në shumën 536,000 lekë. (Trajtuar më hollësisht në faqe 21-24 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

Për sa më sipër rekomandoj:

Duke qenë se në marrëveshjet e bashkëpunimit kërkohet që shpenzimi i fondeve të bëhet në përputhje me rregulloren financiare të institucionit, është nevojë emergjente hartimi dhe miratimi i rregullores financiare të brendshme që të reflektojë jo vetëm kërkesat ligjore por edhe praktikën më të mira në shpenzimin e fondeve të përfituara nga donatorët e huaj.

Menjëherë

Titullari i institucionit të analizojë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për plotësimin e pasaktë të urdhër shërbimeve të periudhës 01.01.2014-31.12.2015 dhe mungesën e sistemeve të kontrollit të brendshëm të institucionit lidhur me këtë lloj shpenzimi.

Menjëherë

Drejtorja e Financës të mos lejojë realizimin e shpenzimeve të cilat nuk dokumentohen në përputhje me kërkesat e VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim brenda vendit” dhe UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Në vijimësi

6. Nga auditimi i përmbledhëses së pasqyrave financiare të Shërbimit Kombëtar të Punësimit, rezultoi se nga dhurimet dhe sponsorizues të ndryshëm institucioni ka përfituar për pajisjen me inventar ekonomik të zyrave të reja të hapura në Berat, Durrës, Fier, Korçë, Elbasan, Vlorë dhe Tiranë në shumën 5,680,540 lekë. Dhurimet nga Projekti Suedez në shumën 1.071.730 lekë për Administratën Qendrore në SHKP. Dhurime nga banka Korçë për QFP Korçë, dhurime nga Programi Usaid e Cars për QFP Shkodër dhe QFP Fier, dhurime nga Bashkia Berat për ZP Berat në shumën 2,655,690 lekë.

Këto fonde të përfituara nuk janë pasqyruar në zërin Grande sipas kërkesave të kontabilitetit. Problematike paraqitet niveli i lartë i të drejtave mbi debitore në rreth 68,687,220 lekë dhe detyrimeve afatshkurtër janë 74,227,988 lekë nga 118,645,844 lekë që ishin në vitin 2013.

Gjendja e lartë e detyrimeve debitore në fund të vitit 2014, vjen nga moszbatim i kontratave nga fondet e nxitjes së punësimit kryesisht në Zyra Rajonale Pune dhe QFP dhe nga humbje në inventar vjedhje të kryera nga viti 1997. (Trajtuar më hollësisht në faqe 33-40 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

Për sa më sipër rekomandoj:

Të merren masa nga ana e institucioni për një politikë kontabël më të kujdesshme në trajtimin e aktiveve të përfituara si grande apo sponsorizime, si në dokumentimin e marrëveshjeve dhe në pasqyrimin e tyre në zërin grande. Të analizohen me përgjegjësi detyrimet debitore dhe të ndiqen të gjitha rrugët për të mundësuar arkëtimin e tyre, për detyrimet pa shpresë arkëtimi të kalohet në një vendimmarrje për heqjen e tyre nga bilanci dhe evidentimin si zë jashtë bilanci. Të ketë një ndjekje të kujdesshme të detyrimeve afatshkurtra për të mundësuar uljen e tyre në vijimësi.

Menjëherë

B. MASA SHPËRBLIM DËMI

Të kontabilizohet dhe të kërkohet në rrugë ligjore shpërblimi i dëmit ekonomik, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera ligjore në të gjitha shkallët e gjyqimit për vlerën **1,007,500 lekë**, si më poshtë:

1. Gjatë auditimit të shpenzimeve për dieta brenda vendit për vitin 2014 u konstatua se, janë likuiduar shpenzime për fjetje në hotel pa dokumente shoqërues të urdhër shërbimit, Faturë Tatimore Shitje për fjetje në hotel dhe kupon tatimor, **15 persona përfitues vlera në total 238,500 lekë**. Janë kryer pagesa për fjetje për qytetin e Shkodrës, largësia e të cilit është nën 100 km, **për 31 persona përfitues në vlerë totale 204,500 lekë**, veprime në kundërshtim me Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, UMF nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim brenda vendit”. *Bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit tabela nr. 1.*

Për vitin 2015, shpenzimet për dieta brenda vendit (shpenzime fjetje në hotel) pa dokumente shoqërues të urdhër shërbimit, Faturë Tatimore Shitje për fjetje në hotel dhe kupon tatimor, **5 persona përfitues vlera në total 24,000 lekë**. Pagesa për fjetje në qytetin e Shkodrës, i cili është nën 100 km dhe nuk përfshihet në dieta me akomodim, **26 persona përfitues, në total 189,500 lekë**, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim brenda vendit”. *Bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit tabela nr. 2.*

2. Gjatë auditimit të shpenzimeve për udhëtim e dieta për vitin 2014, u konstatua se, janë likuiduar shpenzime **për fjetje në hotel, në 83 raste (netë), me vlerë 249,000 lekë pa dokumente shoqërues, Faturë Tatimore Shitje dhe kupon tatimor**, në kundërshtim me Marrëveshjen e Bashkëpunimit me nr. 844 prot. datë 02.05. 2013, të nënshkruar ndërmjet PNUD dhe Shërbimit Kombëtar të Punësimit, mbi zbatimin e projektit nr. 00080624 me titull “Për sfidat e punësimit të rinjve në nivel lokal”, shtojca III, Lista e aktiviteteve, Lehtësitë dhe Pagesat” *ku përcaktohet: Shërbimi Kombëtar i Punësimit do ti mbulojë shpenzimet ditore për transport dhe qëndrim prej 5,000 lekë/ditë dhe 8,000 nëse ka qëndrim dhe fjetje, për stafin që ndjek trajnimin, si dhe me pikën 3 ku citohet: Shërbimi Kombëtar i Punësimit duhet të jetë përgjegjës i plotë për zbatimin me kujdes dhe efikasitet të të gjitha aktiviteteve në përputhje me Rregulloren e tij financiare dhe rregullat e tij.*

*Dietat e përfituara nuk janë paguar në përputhje me një dokumentacion të rregullt sipas kërkesave ligjore në fuqi duke rezultuar si shpenzime të padokumentuara për fondet e përfituara nga grandit i fituar, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit tabela nr. 3. Gjatë auditimit të shpenzimeve për udhëtim e dieta për vitin 2015, u konstatua se, janë likuiduar shpenzime për fjetje në hotel, në 34 raste (netë), gjithsej në shumën 102,000 lekë, pa dokumente shoqërues, Faturë Tatimore Shitje dhe kupon tatimor, në kundërshtim me marrëveshjen e bashkëpunimit të nënshkruar ndërmjet palëve me nr. 1245 prot. datë 21.04.2015 për Shërbimin Kombëtar të Punësimit dhe nr. 173 prot, datë 21.04.2015 për Sëisscontact, Shqipëri, mbi zbatimin e projektit “Këshillimi drejt punësimit dhe sipërmarrjes” shtojca 1 “Etapat dhe bashkëpunimi financiar”, etapa III Kontributet Financiare pika d, në të cilën përcaktohet: Shërbimi Kombëtar i Punësimit do të paguajë stafit të përfshirë në këto aktivitete një tarifë pjesëmarrje/dietë (shpenzime udhëtimi prej 8,000 lekë, në rast akomodimi). *Dietat e përfituara nuk janë paguar në përputhje me një dokumentacion të rregullt sipas kërkesave ligjore në fuqi duke rezultuar si shpenzime të pajustificuara për fondet e përfituara nga grandit i fituar, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit tabela nr. 4.**

C. TË TJERA

1. Duke e konsideruar këtë auditim si një auditim të dobët, jo cilësor dhe jo në përputhje të plotë me standardet e cilësisë së Kontrollit të Lartë të Shtetit, nisur nga fakti që ky auditim do të ripërsëritet sërish në të ardhmen, nuk rekomandojmë asnjë masë administrative apo disiplinore në lidhje me personat e konstatuar me shkelje në Raportin Përfundimtar të Auditimit. Titullari i Institucionit të analizojë konstatimet e këtij Raporti Auditimi dhe të vendosi vetë, për marrjen e masave disiplinore bazuar në përgjegjësitë individuale dhe funksionale të personave të cituar në këtë material.

2. Për audituesen e ngarkuar me përgjegjësi për materialin e dobët të përgatitur dhe neglizhencë në plotësimin e objektivave kryesorë të këtij auditimi, u mor masë disiplinore konform Rregullores së Brendshme dhe Kodit të Etikës të KLSH.

Për shkak të problematikave të trajtuara në pikën 1 dhe 2 të mësipërme (C. Të Tjera), evadimi i këtij materiali u vonua ndjeshëm në kohë.

Për shkak të trajtimit jo profesional dhe me mangësi lidhur me ligjshmërinë e përdorimit të fondeve që kanë shkuar për programet e papunësisë dhe nxitjes së punësimit si dhe të prokurimeve publike të cilat janë zhvilluar nga Shërbimi Kombëtar i Punësimit për periudhën 1 janar 2014 deri në 31 dhjetor 2015, të parashikohet nga Departamenti i Auditimit të Buxhetit Qendror, Administratës së Lartë Publike, Menaxhimit Financiar dhe Auditimit të Brendshëm kryerja e një auditimi tematik në lidhje me këto dy çështje të cilat mbetën të pambuluara nga auditimi.

Brenda vitit 2016

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit Qendror, Administratës së Lartë Publike, Menaxhimit Financiar dhe Auditimit të Brendshëm.